

BIBLIOTEKA

E

814-1

SHTEITI

C 35

GJIROKASTËR

ODHISE ÇERKEZI



Çelën  
qershítë  
poezi

8JH-1  
≤ 35

# ODHISE ÇERKEZI



## Çelën qershite

POEZI

42956



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## ZEMRAT KEMI HAPUR

(*ligjërim*)

Ç'të ndriste belxiku  
nën dritën e hënës,  
trim, o trim i nënës!  
Kur të nisa malit,  
të putha te balli  
dhe të mbiu ylli.

Nur të ri të çeli  
ylli mbi kapele,  
si ylli i mëngjesit.

Ylli kishte brenda  
shtigjet e lirisë,  
që na deshte zemra.

**Kur ju ngjite shpatit,  
çeli syrin dielli,  
shkriu bora e malit.**

**Me dufe lirie  
na vjen pas hapi  
të na sjellsh beharin.**

(mësime)

Pranë ke Karadakun,  
dot s'ju ndau hasmi,  
lule, Asim djali!

Zemrat kemi hapur,  
lule pikon malli,  
o sorkadh i malit.

Ku ke shkelur ti,  
të vijnë tani shokët  
me grushtin te balli.

**Ylli seç ju digjet,  
mbi mermér tē bardhë,  
zemra juaj gjallë!**

### **CETËN D'ERZHENITË**

Ylli seç ju digjet  
mbi mermér tē bardhë  
zemra juaj gjallë!  
  
Mëndafishtët e së putojët  
dëshironin që të vërtetë  
të vënë me shërbim  
në këtë qytet.  
Dëshironin që të vënë  
me shërbim, që  
të vënë me shërbim  
në këtë qytet.

Ylli seç ju digjet  
mbi mermér tē bardhë  
zemra juaj gjallë!  
  
Mëndafishtët e së putojët  
dëshironin që të vërtetë  
të vënë me shërbim  
në këtë qytet.  
Dëshironin që të vënë  
me shërbim, që  
të vënë me shërbim  
në këtë qytet.

Ylli seç ju digjet  
mbi mermér tē bardhë  
zemra juaj gjallë!  
  
Mëndafishtët e së putojët  
dëshironin që të vërtetë  
të vënë me shërbim  
në këtë qytet.  
Dëshironin që të vënë  
me shërbim, që  
të vënë me shërbim  
në këtë qytet.

## ÇELEN QERSHITË

Në fshatin tim, atje në Jug,  
qershitë prej kohësh kanë çelur.  
(dikur ato, kur isha fëmijë,  
rrihnin krahët në dritare  
dhe më thërrisin: «Eja! Eja!»,  
dhe unë vrapoja me krahët te pranvera.)

Nga flladi i mallit tim  
dhe këtu në Mirditë  
qershitë sivjet çelën më shpejt,  
si në fshatin tim, atje në Jug.

Tundin degët,  
na dërgojnë petale,  
sikur të na thërrisin të gjithëve: «Eja, eja!»

Tani nxënësit e mi  
më shpesh i kthejnë sytë nga dritarja  
dhe unë shoh si feston në to  
ngazëllim i bardhë pranveror.

## **NË SY UA KEMI FLUTURIMIN**

Përkalem mbi vocërrakët e mi,  
u shoh sytë, u dëgjoj ligjërimin,  
u përkëdhel faqet trëndafili,  
u lexoj dëshirat  
në sy, në ballë, në gishta.

Cicëri sot nëpër klasa anembanë,  
vogëlushë të dashur, cicëri;  
ne në sytë tanë qysh tani  
ua kemi fluturimin.

## *NJË MURANE...*

Pashë një muranë ndanë rrugë,  
një njeri dikur i vrarë në pritë,  
një muranë.

Një amanet i kobshëm  
nënshkruar nga gjaku  
në biografinë e fisit,  
një muranë.

Një njeri i paguar  
dhe në çarkun e dyfekut  
gishti i fshehur i bajraktarit,  
lidhur me besën e krimtit,

për të grabitur kullën,  
për të grabitur arën,  
për të grabitur jetën.

Një pushkë e mbetur në gozhdë pa zot,  
ara me kallinj të ronitur në një stinë dhimbjeje,  
fëmijë jetimë në kullën e nxirë,  
një muranë.

Vdekja si hije duke ndjekur  
vazhdimesht njerëzit e fisit,  
që nga lindja gjer në mosqenie,  
një muranë e lashtë ndanë udhës:

## **KUR BASHKOHEN UDHËT**

Në trenin e Laçit u njohëm një ditë,  
ti shkoje në Fierzë, unë në Mirditë.

Fjalë të thjeshta thamë, pa lulka stoli,  
një gëzim i bardhë na rrinte në sy.

Në trenin e Laçit shumë herë u takuam  
siç takohen linjat, që kaq shumë i duam.

Ja na thirri koha dhe një ditë u nisëm  
në brigadë me shokët vullnetarë në Fierzë.

Zbardhete e ndriste fusha, qeshte e rritej bota,  
hapej horizonti, malet ulnin kokat.

Gjëmonte turbina Drinit vrulleshumë,  
krah për krah të dy gjokset dhe ne i vumë.

zgjedhjet që ër gjatodha e t'ip dhimitrex ka  
qendiq qaf jë t'ip sot që o mëqeb is  
ministrat që koha bënoj arti fshata viktimët e qesa  
dherme t'ek bollojti qëndron e që dërti qëm dig.  
Mëqebet e qesa së shumësh qëm dheraq qëm i fuqisht

## NJË HISTORI E DHIMBSHME...

I vetmuar, i rreckosur, i uritur,  
me shtatë gojë që prisnin të uritura,  
me një sépatë dhe një trastë  
endej i pashpresë nga mëngjesi në mbrëmje  
malësori fytyrévrarë  
dhe bërtiste:  
«Dru me pre!»

Qyteti me gjëmimin e frikshëm  
të këmbanave  
e mbyste thirrjen e tij.

Zoti, për të cilin fliste çdo ditë prifti, ishte shurdhuar  
prej kohësh,

si zotërinjtë që e shikonin në sy indiferent,  
si dyert e tyre që s'i hapeshin,  
sepse kishte shumë malësorë si ai që thërrisinin:  
«Dru me pre!» me zemrën mbledhur grusht,  
«Dru me pre!» me dhëmbë të shtrënguara.

Po një ditë ca njerëz të varfër,  
ca njerëz me besim të fortë në të ardhmen,  
i treguan rrugën e vërtetë.

Duhej goditur nga rrënjet  
e vjetra dhe robëria,  
i duhesin prerë rrënjet mjerimit e pabarazisë,  
që ai të mund  
të gëzohej për herë të parë në jetë!

## VALLET DROPULLITE

Një hap i lehtë si dridhje zemre,  
një fllad shamie flakërim,  
që derdhet në hare vjolie  
dhe qindra zemra përtërin.

Gerneta bie, dridhet vallja,  
hënën në ballë, diellin në gji  
vini në dasma e gëzime,  
nga skenat derdhni vezullim.

Gajtanë vallesh dropullite,  
C'behar ju mrekulloi kështu,  
që bujarisht ngado ju derdhni  
fillade gëzimesh të pafund.

## **PASHË NJË FËMIJË QË PËRQAFQHEJ ME LULET...**

Pashë një fëmijë që përqafqhej me lulet,  
dy duar që përqafonin pranverën  
dhe nënën që përqafonte fëmijën,  
sikur të përqafonte agimin.

Qeshte fëmija e lumturohej nëna  
dhe ngjante sikur thoshin sytë e saj të lumtur:  
— Qesh, i miri i nënës, udhët ku do shkelësh,  
do të të bëhen lule!


doort i mëda  
doktoret qëndrojnë  
në këtij viti është e nxeqenë zot  
Herra Mësuesiq

## S H P A G I M

Bariu Mark  
kishte një maraz,  
ia kish plagosur zemrën  
beu bajraktar.

«Mark bajga»  
bajraktari e kish thirrur,  
se në haur të lopëve  
kishte lindur.

«Të gjitha janë të miat,  
o Mark bajga;  
dhe toka ku ti shkel,  
dhe dita, dhe nata.



42856

Kështu i thosh  
bariut bajraktari,  
tek ngryste e gdhinte ditët  
përpjëtë malit.

Bariu Mark  
e qante fyellin mirë,  
herë me maraz  
e herë me dëshirë.

Tek djemtë, në mal  
u ngjit përpjetë,  
që pranga e derte  
ky dhé mos ketë.

Dhe ja, një ditë  
mes ditëve furtunë,  
në haur të lopëve  
beun na e zunë.

Plumbin ç'ia mati Marku  
dhe briti nga gëzimi:  
«Këtu është fundi yt,  
bej bajga, jo i imi!»

juatëkë vëqën e atozi vëqëkë  
çiftët e çiftët këmbeq an  
zimnde isq laten tikan që që që  
mëdherët shumë ishëmëtë mëndherët n'it

## NGJITESH LARTËSIVE

Malësorëve që shkuan në metalurgji

Tek oxhaku ngjitesh lart,  
sikur ngjitesh majë bjeshkës.  
Hej, kjo lartësi e re  
zemrën seç ta merr me vete.

Të thirri metalurgja  
si të thërriste bjeshka dje,  
e le kullën në ato male,  
ngjite lartësi të re.

Ngjitesh, ngjitesh ç'të kap syri,  
gjithë kjo është bota jote.  
N'atë bjeshkë vetullkurorë,  
botë të tillë kurrë s'ëndërrrove.

Nëpër mote e nëpër shekuj  
ne përmbi thesare flimin,  
po një grusht metal për plumbat,  
t'ia derdhnim pushkës nuk kishim.

S'kishim një copë për pluar  
e për tokën e zhuritur,  
të vinte behar i bukur  
n'ato malet e uritur.

Ja metali çurkë derdhet,  
valë-valë çelik i kuq,  
në atë dallgë sot seç digjen  
ligje të egra dhe kanun.

## *ËSHTË MBLEDHUR BATALIONI*

M'u te Borshi më të dalë  
ku vjen vendi erë limoni,  
dil, o Sofo, lule djalë,  
është mbledhur batalioni.

Shokët bien erë lufte,  
shokët këngë mali thonë;  
prushi i tyre ndez barutin,  
që na hedh sërish në front.

Yje, yje pikoi gjaku,  
ku të ra mortaja pranë,  
për liri dritë zambaku  
ç'e bëre këmbën dhe krahnë.

Mu te Borshi më të dalë  
vendi bie erë limoni,  
dil, o Sofo, lule djalë,  
është mbledhur batalioni!

## *UNE VIJ PAS TEJE*

Në dyert e zemrës sime, e dashur,  
ti vjen e troket herë-herë  
dhe më zgjon mallin,  
dhe më zgjon flladet  
si pranvera që zgjon blerimin.

Herë-herë ti vjen e më merr me vete,  
ti je si një shteg i njohur i vendlindjes,  
që të thërrret në ngazëllim fëminor.  
Unë pas teje vi,  
ti je zëri i ëmbël i zemrës,  
që e dëgjoj vazhdimesht.

## PËR SINORIN E ARËS

I shtrënguam duart njëri-tjetrit  
këtu në Urakë,  
mbi Urën e Erërave.

Dikur ne kishim rrëmbyer pushkën  
për një pëllëmbë tokë,  
për sinorin e arës.

Atje te sinori i arës,  
te gorrica e vjetër  
ishte sinori i jetës dhe i vdekjes.

(Në netët e zeza të kanunit  
dikush kishte shtyrë sinorin e arës,  
pastaj pabesia do të shtynte fishekun e pushkës).

Kështu kishte krisur pushka për kufijtë e arës  
që u vadir nga gjaku,  
po ne vumë duart,  
që mos pengohet e ardhmja,  
që jeta jonë të mos pengohet.

## **PRANË PLISIT TË TOKËS MËMË**

Pashë një plak të thinjur, të kërrusur nga vjetët,  
përkulur pranë plisit të tokës mëmë;  
diçka po i pëshpërliste tokës së lëruar  
dhe e përkëdhelte ëmbëlsisht në pëllëmbë.

Dhe ngjante se thoshin dy sytë e menduar:  
«Në qdo pore, o tokë, ta kemi futur lirinë,  
që të çelin vetëm stinë begatje  
e mos e njoħeš kurri prapë varférinë!»

## **NE KËTË QYTET TË GURTË...**

Në këtë qytet të gurtë  
kam lënë një pjesë të jetës sime,  
ashtu si lënë dhe të tjërët,  
ata që i jepin qytetit ftyrën e kohës,  
ata që ranë  
apo ata që nesër do të lindin.

## **NË FIERZË KISHA BUJTUR ATË NATE**

Ishte dy apo tre pas mesnate,  
s'e mbaj mend se çfarë ore ishte.

Zëra të shqetësuar vinin nga çdo anë:  
«Tek diga, shokë!»

Unë në Fierzë kisha bujtur atë natë  
dhe isha mik në një barakë punëtorësh,  
kur ndjeva zërat që vinin mes shtrëngatës,  
kërceva që nga shtrati bashkë me shokë.

«Mos eja ti» më tha një nga punëtorët,  
një tjetër buzëqeshi ironik  
dhe ish njësoj sikur të më thoshte:  
«Nuk janë për ty këto punë, mor mik!»

Ndërsa një tjetër më pa në sy gëzueshëm:  
«Merri këto çizme shpejt», — më tha,  
më hodhi një mushama në krahë  
dhe «Ec të shpejtojmë, se koha s'pret, vëlla!»

Vrapova shpejt pas tij, emrin s'ia dija,  
po veç ai ma ndjeu trazimin tim në shpirt  
dhe i vura me të tjerët gjoksin Drinit,  
çdo dallgë më ngrinte një dallgë të re në gji.

Dhe ra mëngjesi,  
dielli na kish mbushur sytë.  
Atë mesnatë te diga e madhe e Drinit  
pashë ç'do të thotë bashkim e sakrificë.

## **KONSTELACIONE**

Fishekzjarret fluturuan një çast,  
shkrepën,  
vezulluan gëzueshëm  
dhe u shuan.

Po ne na mbetën në sy  
konstelacionet e gëzimit  
në qiellin e pafund të festës,  
si udhët e reja  
që do të marrim nesër.

## ***DIÇKA NGA KANUNI***

Mbrëmë nga kulla e fundit atje në fshat  
një malësore me sy më përçolli.  
Prilli flladiste lule në çdo prag,  
asaj i flladitej kraharori.

Gjer larg më ndjek përherë shikimi i saj  
fshehur prapa kumbullës tek oborri,  
kur i thërres në emër dhe i shkoj pas,  
faqet si mollë i prushërojnë.

Unë kam qenë disa herë në kullën e saj  
dhe babanë e saj e kam mik;  
ajo më do, unë këtë e di,  
po m'i vidhet takimet me frikë.

Mua askush s'më ka zënë pritë  
për këtë vajzë që nusja ime do të bëhet,  
po gjersa ne s'takohemi lirisht,  
diçka nga kanuni akoma në të ka mbetur.

## *DRURI I LAHUTËS*

Druri i lahutës  
si dru këngëtar  
thotë legjendën e fisisit tim.

Druri i lahutës  
po zemër që këndon,  
gishta që dridhen me mall,  
kraharor që buçet.

Druri i lahutës  
prej dimrave dhe derteve që u shuan  
duhej të ishte tharë dhe thinjur patjetër.

Po druri i lahutës,  
si shpirti i bardhë i malësorit,  
thoshte këngë  
që kishin në zemër pranverën.

## **NË DITËN E DASMËS**

Kali i bardhë nuk erdhi të të marrë,  
as pushkë nuk ranë tej në bjeshkë.  
Ti ike nga shtëpia e babait,  
duke shkuar në punë, fare thjeshtë.

Karvani i krushqve ngeci diku larg,  
iu bënë lumë lotët e dikurshëm të nuseve,  
ti ishe nusja e parë në fshat,  
që ndryshe e prive karvanin e krushqve.

Ti ike nga shtëpia e babait  
si shkoje në punë ditë për ditë;  
të priste parcela e madhe me grurë,  
një ligjërim shushurinin kallinjtë.

Dhe në mbrëmje, atje rrëth duajve,  
u ngritën dollitë dhe u zu vallja.  
Ti s'vure vello hëne përmbi ballë,  
atë ditë flamurin kish fituar brigada.

## **PLAKU PRENGË**

Plaku Prengë është shtatëdhjetë e pesë vjeç,  
që dhjetë vjeç  
babai i vuri pushkën në duar.  
Natë për natë Prenga  
del nga kulla me pushkë;  
(me pushkën e tij,  
që në shumë luftëra ka gjëmuar).

Ecën plaku Prengë me pushkën në krah,  
se e di fort mirë,  
se armiq tej kufijve përgjojnë në errësirë  
dhe presin një çast të biem në gjumë,  
të na sulen,  
thikën të na ngulin në shpinë.

Dyzet dimra të rëndë robërie  
i rëndoijnë bacës mbi shpinë,  
dhe tridhjet e pesë pranvera lirie  
ia rinojnë zemrën e mirë.

«Si s'të ka lodhë pushka, or Prengë?!»  
Ai qesh me kokën mënjanë  
si në një këngë të dashur majekrahu  
dhe flet siç dinë të flasin burrat e malit:  
«Jetën që na dha Partia, or djalë,  
e kemi te pushka,  
dhe syrin te pushka,  
dhe zemrën te pushka!»

## **FJALE SHQIPE, HOJE MJALTI**

*Naim Frashërit*

Nëpër male, nëpër luftra, nëpër mote dit'e netë,  
zëri yt gjëmim kushtimi jehon thellë tokës mëmë.

Ku është trupi, ku është zemra, nga Stambolli në  
Shqipëri,  
dyzet male e dyzet fusha çan e vjen plot mall në gjë.

Qan xhuraja në një breg, dolën stanet për verim,  
vargu naimjan seç derdhet porsi fllad e gurgullimë.

Në mes prangash, në mes burgjesh, në mes plagësh  
e errësirë,  
shkel e shkon, shpërthen e s'mbahet zemra e tij  
përherë e lirë.

Nëpër mote, nëpër male me bajrak e shkabë në  
ballë,  
ato fjalë hoje mjalti na dhanë dritë, na mbajtën  
gjallë!

## *BJERI, LAHUTAR*

Bjeri, lahutar,  
shkundi gjithë lulet  
dhe gjithë ligjërimet;  
mos harro as dertet,  
mos harro kushtimet.

Bjeri, lahutar!  
Pse të dridhen gishtat  
sikur po heq çarkun,  
sikur po shtyn plumbin  
në pritat e gjakut?!

O ç'dergjej lahuta  
me plagë në gji,  
pastaj nxirrte klithma  
për një pabesi.

Po mbi gjithë tingujt  
që gjëmontejeta,  
ngrihej trimëria  
mbushte lugje, shkrepë.

Dhe na vjen në vite  
mijëra ngjyra ndritin,  
në zemra hyn bjeshka,  
në tela shkëlqimi.

Ç'ke në zemër brenda,  
ç'ke në sy, në gishta,  
derdhi ngjyra, tinguj,  
zëra të magjishëm.

Bjeri, lahutar!  
Qeshin trojet tonë,  
gazi rrjedh si Drini,  
kënga si Valbona.

## *DRITËS I HAPA UDHËN E MADHE*

Ish shtëpia jonë e gjithë Shqipëria,  
nga vatra fshatare  
te baraka punëtore;  
nga Vadeja, në Fierzë e Koman shtegtuam,  
në digat e Drinit  
duke vënë kraharorë.

Me pistolin në duar  
i shtyva unë malet  
dhe dritës i hapa udhën e madhe;  
nga krifat e kërleshura të dallgëve  
buron e buron drit' e bardhë.

Shirita inaugurimi m'u bënë ylberet  
që u zgjatën

mbi diga, turbina e male;  
në dritën e bukur  
që ju ndrin çdo çast  
rreh dhe zemra jonë  
si ujëvarë vigane.

## *NË ÇDO LLAMPË QË NDIZET...*

Punëtorët e dritës i takoj shpesh.  
Kanë një dritë të butë brenda në sy  
dhe në hap kanë një vrull të fshehtë  
dhe ca trëndafila në buzëqeshje,  
që në asnje kopsht nuk i gjen.

Kur përshëndetemi  
dhe shtrëngojmë duart,  
forcën e lumit ndiejmë në duart tonë;  
dallgën që derdhet me vërtik  
nëpër turbinë  
dhe bëhet dritë.

Diçka kanë nga lumi tek sytë,  
nga zëri derdhet një dritë ledhatare,

ai gaz, ngrohtësi dhe dritë,  
që na sjell mbrëmja rreth tavolinës.

Në çdo llampë që ndizet  
portreti i tyre qetas na buzëqesh.

## TË RËNËT

Toka eshtrat jua ruan,  
që të na forcojë qëndresën.  
Shamizezat vijnë të gjitha tek ju,  
malli në sy, në ballë krenaria.  
Në buzë kanë emrat tuaja  
dhe mbi to si kurorë ligjërimet;  
nuk harrojnë asnjë.  
Partia ju bëri shokë që të gjithë,  
ç'hijeshi e dritë që ka lëndina!

Qëndrojmë para jush me grushtet shtrënguar,  
hesht mermer i bardhë,  
heshtin bari, lulet,  
vetëm amanetet që na latë në zemër  
shtohen dhe madhohen  
dhe pulsojnë damarët.

Betohemi në heshtje për amanet!

## *M B R È M È . . .*

Mbrëmë u kthyem vonë nëpër kulla  
djem dhe vajza që mblodhëm bukën e malit;  
era këndonte bukë, bukë,  
vajzave u qeshte hëna te balli.

Mbrëmë u kthyem vonë nëpër kulla  
me duaj kallinjsh nëpër duar,  
kurse mali rrinte i heshtur përballë,  
sikur të mendonte për motet e shkuar.

Mbrëmë u kthyem vonë nëpër kulla,  
drita shkëlqim të ri u jepte dhomave,  
shije tjetër kishte edhe buka  
dhe fëmijët ndryshe qeshnin mes ëndrrave.

## **I ÇOJ FJALE SË BUKUREŞ**

*(motiv populor)*

Nëpër degë të mollës  
i çoj fjalë së hollës.  
E holla nuk më dëgjoi,  
bashkë me shoqet shtegut shkoi.

Nëpër degë të kumbullës  
i çoi fjalë së bukurës.  
E bucura diçka tha,  
rrëzoi mandilen në krah.

Nëpër degë të dardhës  
i çoi fjalë së bardhës.  
E bardha më dëgjoi,  
ngriti sytë e më shikoi.

Molla zuri kokrra,  
ç'i mblodhi e holla,  
e holla, e bardha,  
sy e vetull shkaba.

Rrëzoj fletët kumbulla,  
po ngarkon e bukura.  
Ku po shikon, moj faqepjeshkë,  
atje lart në atë bjeshkë?

Në atë bjeshkë e mal me borë,  
kam një trim vetullkurorë.  
Trimi im çetinë më çetinë  
malet çan e na sjell dritë.

## B E S I M

Kalbeshim në një prill  
a në një vjeshtë  
pranë arës,  
që e kishim ëndërruar përjetë.

Gëzonte bajraktari,  
sundonte  
në sarajet e bardha  
nga gjaku ynë.

Oh, shihmani kraharorin!  
E kam shoshë nga plagët,  
nga çdo plagë  
dhe nga një klithmë për jetën.

Shihmani kraharorin!  
Një plumb e kam pér vllaun,  
pér axhën dhe dy plumba  
dhe që të trija nga bajraktari;  
dhe katër të tjera  
nga hasmi i huaj.

Po dhe kur mirrnim plumbin  
prapë besonim se jetën  
do ta ndërtonim të bukur si buzëqeshja  
dhe s'gabuam,  
kështu na tha Partia.

## *PRITE, O PRITE AZEM GALICËN!*

Prite, o prite Azem Galicën!  
Ish kjo thirrje férshëllimë plumbash,  
përcëllimë urejtjeje pér hasmin.

Prite, o prite Azem Galicën!  
Thërriste Shota e thërrisin bijtë,  
po Azemi shtrirë mbi vig  
shkrepte armët dhe pa frymë;  
shkrepte armë, tmerronte hasmin,  
s'vdes kush bie pér vatanin!

Shota shihte luftëtarët,  
një pér një në sy i shihte;  
ata hidheshin në zjarr  
dhe gjëmonte prapë kjo thirrje:  
«Prite, o prite Azem Galicën!»

Shkrepte pushkën e dridhej toka,  
përballë trimërisë së saj  
burrave u skuqej faqja.  
Vinte syrin, shkrepte çarkun:  
— Na, o qena, plumb shqiptari!  
Pas çdo krisme ngrihej prapë:  
«Prite, o prite Azem Galicën!»

Shotës ç'i gjëmonte gjirit  
ky tërmët e ky kushtrim,  
edhe një dëshirë e flaktë  
seç i rritej thellë në gji:  
donte gjithë djemptë e bjeshkës  
bij të saj, përjetë të ishin;  
t'i rriste kreshnikë e trima,  
që mos shuhej kurrë kjo thirrje:  
«Prite, o prite Azem Galicën!»

## *KJO SHAMI E DJEPIT*

Kjo shami e djepit mbushur me zambak,  
rritu, bij' e nënës-o, të ngjitesh në mal.

Kjo shami e djepit-o me lule behari,  
rritu, bij' bijëzo, të shkosh vullnetare.

Kjo shami e djepit-o, o me dritë hëne,  
çupa jonë me traktorë fushave do rendë.

Fushat janë të blerta, fushat janë të gjera,  
atje janë thesaret që na i do zemra.

Kjo shami e djepit me lule si fusha,  
rritmu, moj thëllëzë, se po të pret pushka.

Në ato sy të bukur si yje me çika,  
nur i ri që ka nënë Shqipëria.

bilg isolaq s̄t r̄mən̄t  
ḡt̄v̄/h̄t̄ o t̄l̄qipd̄  
Bilgiliq s̄nḡr h̄t̄ q̄llab-q̄plab  
s̄l̄q̄f̄ l̄tarid̄q̄ n̄f̄sl̄ h̄

## C'T'U VĒRSULËN KRAJLË E MBRETËR

C't'u vērsulën krajlë e mbretër,  
perandorë e padishah;  
kurse ti me pushkë krahut  
sillje ditët e mëdha.

Carët e Kremlinit ç'deshën,  
që t'u sulën si tufan;  
djemtë e tu pallën zhveshën,  
s'pyetën car e caristan.

Perandorët e Pekinit  
me pranga si «miqtë» e tjerë,  
kokë më kokë me Amerikën  
bënë planet këtë herë.

C'trimëri të paska gjiri,  
Shqipëri e ndritura;  
dallgë-dallgë të vijnë armiqtë,  
ti kala përmbi kala.

## *DJALOSHI BILL*

*(Pamje nga Amerika)*

Djaloshi Bill nuk ka njeri,  
nuk ka as punë, as prindër, as shtëpi,  
po në qdo rrugë e në mjerime gjen  
me mijëra vëllezër plot mëri.

Babanë e tij të bardhët ia linçuan  
dhe kushedi ku i erdhi çasti i fundit;  
në një hambar anije ai lindi,  
në vend të djepit dallga e përkundi.

Çdo rrugë e avenju e autostradë  
dhe qdo reklamë nga gjaku i tij ndriçon,  
dhe ecën nëpër rrugë e pështyn gjak  
e një mëri e thellë e përvëlon.

Djaloshi Bill barkun e ka bosh,  
djaloshi Bill është gjysmëlakuriq;  
boritë e veturave dhe reklamat  
edhe në ëndërr e shpojnë si thikë.

Ndaj këtë botë, ku kapitali shtyp,  
edhe sundon mbi popujt me kamxhik,  
djaloshi Bill për vdekje e urren,  
edhe me të do ndeshet keq një ditë!

## *MEGAFON I KUQ*

*Grupit artistik marksist-leninist gjerman,  
«Megafon i kuq»*

Ju erdhët që nga larg, vëllezër,  
ne hapëm zemrat, hapëm krahët,  
ju pritëm porsi luftëtarët  
në vijë të parë të barrikadës.

U ngjitët nëpër skenat tonë  
dhe që të gjithëve na gjëzuat,  
dhe marshet porsi dallgë baruti  
nga «Megafon i kuq» gjëmuani.

Zëri gjëmon, përflaket skena,  
si zjarr i ndezur barrikade,  
me plumb e këngë breshëri  
përpara çan e s'di të ndalet.

Kështu, vëllezër, luftë e klasës  
nuk është slogan e fjalë parade,  
po është përmbyshje, lumë gjaku,  
lirinë e sjell veç gryk e armës.

## TRE PERANDORE

Tre perandorë  
edhe ca mbretër  
dhe njëqind shtete  
gjuhëprera  
menduan natë,  
menduan ditë  
ta ndajnë botën  
thela-thela.

Njëri vec  
pendët kish të kuqe,  
tjetri atom  
nën veladon,  
bilbili-gjyzar  
ish i treti,  
për komunizmin  
ligjéron.

Po që të tre  
na qenë betuar  
thelë njëri-tjetrit  
mos t'i lënë.

Njëri me emblemë elefanti,  
i dyti car skeptërargjend,  
i treti perandor i verdhë,  
të tre me salltanet të rëndë.

Dhe si me shkop magjik  
kërkonin  
popujt' ti vinin  
krejt në gjumë,  
të tre si Zeusi  
gjëmonin  
sillnin  
zinxhirë,  
atom,  
opium.

Si ujk,  
si dhelpër,  
si çakall  
kishin ata zakon të parë

që komunizmin  
pre ta bëjnë,  
t'ia pinë gjakun  
në damarë.

Po shqipja flatrat  
shtrin në diell,  
e s'pyet për ta,  
e për shtrëngatë,  
e popujt  
nëpër barriksa  
e përshëndesin  
me grushtin lart!

Shtrëngata vjen,  
rrufeja shkrep  
borgjezët struken prej mynxyrës.  
Në ballë  
lufitëtarët.  
Revolucioni proletar  
vjen që t'ia ndrisë  
botës fytyrën.

## *PASQYRA E LËNDËS*

Zemrat kemi hapur .....	3
Çelën qershítë .....	6
Në sy ne kemi fluturimin .....	8
Një muranë... .....	9
Kur bashkohen udhët .....	11
Një histori e dhimbshme .....	13
Vallet dropullite .....	15
Pashë një fëmijë që përqafohet me lulet... .....	16
Shpagim .....	17
Ngjitesh lartësive .....	19
Eshtë mbledhur batalioni .....	21
Unë vij pas teje .....	23
Për sinorin e arës .....	24
Pranë plisit të tokës mëmë .....	26
Në këtë qytet të gurtë .....	27
Në Fierzë kisha bujtur atë natë .....	28
Konstelacione .....	30
Diçka nga kanuni .....	31
Druri i lahutës .....	33
Në ditën e dasmës .....	35

Plaku Prengë .....	37
Fjalë shqipe, hoje mjalti .....	39
Bjeri, lahutar .....	41
Dritës i hapa udhën e madhe .....	43
Në çdo llampë që ndizet.: .....	45
Të rënët .....	47
Mbrëmë .....	48
I çoj fjalë së bukurës .....	49
Besim .....	51
Prite, o prite Azem Galicën! .....	53
Kjo shami e djepit .....	55
Ç't'u vërsulën krajlë e mbretër .....	57
Djaloshi Bill .....	59
Megafon i kuq .....	61
Tre perandorë .....	63

Cështje despitje besimi e Naimi

Lekëdha 1980

1-80

(Bart qira)

1-80 - 991985-1 (x.11)

6-80

Çerkezi, O.

Çelën qershitë. Poezi. T., «Naim  
Frashëri», 1980.

68 f.

(B.m.) dhe

(B.v.): 891.983-1

C 35

Tirazhi 1500 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1980.